



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA  
RÉPUBLIQUE DE KOSOVO



KOMUNA OBILIQ - OPŠTINA OBILIČ - MUNICIPALITY OBILIC

Nr. Br. No.

10-020-01-12791-25

Nr. i fq. / Br. str. / No. pg.

Data / Datum / Date

14.05.2025

OBILIQ - OBILIČ - OBILIC



## MEMORANDUM I MIRËKUPTIMIT

në mes:

### Drejtoria Komonale të Arsimit të Komunës së Obiliqit

dhe

**Teach For Kosova**

#### Neni I

##### Qëllimi

1. Qëllimi i këtij Memorandumi të Mirëkuptimit (në vijim: Memorandumi) është të vendosë një kornizë bashkëpunimi ndërmjet organizatës Teach For Kosova (tutje edhe: TFK) dhe Drejtorisë Komonale të Arsimit të Komunës së Obiliqit (tutje edhe: DKA) për implementimin e programeve të Teach For Kosova në shkollat e kësaj komune.
2. Bashkëpunimi synon të kontribuojë në përmirësimin e cilësisë, gjithëpërfshirjes dhe barazisë në arsimin parauniversitar në Komunën e Obiliqit, përmes zhvillimit dhe zbatimit të aktiviteteve të strukturuar dhe të përshtatura për nevojat e nxënësve dhe mësimit në shkollat fillore dhe të mesme, duke promovuar mësimin e orientuar drejt nxënësit, zhvillimin profesional të mësimit në shkollat, si dhe angazhimin aktiv të komunitetit shkollor dhe jashtëshkollor.

#### Neni II

##### Obligimet e Komunës së Obiliqit

Drejtoria Komonale e Arsimit të Komunës së Obiliqit angazhohet që gjatë periudhës së zbatimit të Memorandumit:

1. Të shërbejë si urë lidhëse ndërmjet TFK-së dhe shkollave për çdo aspekt operacional dhe koordinues të bashkëpunimit.
2. Të sigurojë qasje të plotë në shkollat e Komunës për procesin e rekrutimit të nxënësve për Shkollën Verore të organizuar nga TFK, duke përfshirë: lehtësimin e kampanjës informuese dhe promovuese, shpërndarjen e materialeve promovuese (broshura, fletëpalosje, etj.), ndërtimin e kontakteve me mësimit në shkollat, drejtorët e shkollave dhe prindërit, si dhe mbështetjen e komunikimit me komunitetin lokal.
3. Të sigurojë transportin ditor për 50 nxënës nga shkollat e Komunës së Obiliqit për pjesëmarrjen e tyre në Shkollën Verore që zhvillohet për dy javë në Prishtinë, duke garantuar kushte të sigurt dhe të përshtatshme udhëtimi.
4. Të ofrojë qasje dhe bashkëpunim për zbatimin e projekteve dhe programeve potenciale të TFK-së në shkollat e Komunës së Obiliqit, me fokus në rritjen e cilësisë arsimore dhe përfshirjes sociale.



5. Të identifikojë dhe të informojë TFK-në për lëndët deficitare në shkollat e saj, duke komunikuar në kohë reale nevojat për staf mësimor, në mënyrë që të mundësohet koordinimi dhe angazhimi i mësimdhënësve (Fellows të TFK-së) të përshtatshëm për plotësimin e atyre pozitive, në përputhje me kapacitetet e TFK-së.
6. Të ndihmojë TFK-në në organizime potenciale të ngjarjeve të ndryshme në Komunën e Obiliqit për të raportuar apo shpërndarë punën e TFK-së në rritjen e cilësisë dhe gjithëpërfshirjes në arsim.

### **Neni III**

#### **Obligimet e Teach For Kosova**

Teach For Kosova angazhohet që gjatë periudhës së zbatimit të Memorandunit:

1. Të përfshijë nxënësit e shkollave të Komunës së Obiliqit në secilin edicion të Shkollës Verore të cilën TFK e organizon në Prishtinë, me pjesëmarrjen e 50 fëmijëve/nxënësve nga shkollat fillore të Komunës, duke promovuar veçanërisht pjesëmarrjen e nxënësve nga komunitetet pakicë (Rom, Ashkalinj dhe Egjiptian), me synim fuqizimin arsimor, social dhe emocional të tyre përmes një programi kreativ mësimor.
2. Të zbatojë projektet dhe programet e TFK-së në shkollat e Komunës së Obiliqit, në përputhje me kapacitetet teknike, financiare dhe njerëzore të organizatës.
3. Të ofrojë mësimdhënës për lëndët deficitare në shkollat e Komunës së Obiliqit, në koordinim me DKA, duke ndihmuar në mbulimin e mungesës së kuadrit arsimor cilësor.
4. Të sigurojë mbështetje të vazhdueshme profesionale për Fellows që vijnë nga Komuna e Obiliqit dhe ata të cilët angazhohen në projekte dhe mësimdhënie në shkollat e Komunës së Obiliqit përmes programit të TFK-së, duke realizuar vizita në terren, observime pedagogjike, këshillim individual dhe trajnime të rregullta të bazuara në metodologjitë më bashkëkohore të mësimdhënies dhe mësimnxënies.
5. Të promovojë dhe lehtësojë angazhimin e komunitetit në shkollat pjesëmarrëse përmes aktiviteteve që nxisin bashkëpunimin ndërmjet mësuesve, prindërve dhe institucioneve lokale me qëllim krijimin e një mjedisi mbështetës për të gjithë nxënësit.
6. Të organizojë ngjarje me interes publik në Komunën e Obiliqit për të promovuar dhe shpërndarë programet dhe aktivitetet e TFK-së që kanë në fokus rritjen e cilësisë dhe gjithëpërfshirjes në arsim.

### **Neni IV**

#### **Vendi dhe kohëzgjatja**

1. Ky memorandum hyn në fuqi nga data e nënshkrimit dhe mbetet i vlefshëm për një periudhë katërvjeçare, me mundësi vazhdimi përmes një aneksi-memorandumi.



2. Zbatimi i aktiviteteve të parashikuara në këtë memorandum shtrihet gjatë gjithë vitit kalendarik për secilin vit të bashkëpunimit, në përputhje me planin vjetor dhe strukturën programore të TFK-së.
3. Aktivitetet zhvillohen në lokacione të ndryshme, përfshirë Komunën e Obiliqit (në shkollat përkatëse dhe komunitet), Komunën e Prishtinës (për aktivitete si Shkolla Verore dhe trajnimet qendrore të organizuara nga TFK), dhe lokacione të tjera të caktuara sipas natyrës dhe qëllimit të secilit aktivitet të TFK-së.

#### **Neni V**

##### **Partneriteti, ndryshimet dhe mosmarrëveshjet**

1. Palët e pranojnë njëra-tjetrën si partnerë zhvillimorë në fushën e arsimit dhe inkurajojnë mbështetjen e këtij bashkëpunimi dhe programit të lartshënuar edhe nga palë të tjera.
2. Çdo ndryshim në këtë Memorandum duhet të kërkohet me shkrim të paktën 14 ditë më herët nga njëra palë dhe të miratohet nga të dyja palët.
3. Çështjet e diskutueshme apo mosmarrëveshjet do të trajtohen në frymën e bashkëpunimit dhe mirëkuptimit të ndërsjellë.

#### **Neni VI**

##### **Kopjet dhe hyrja në fuqi**

1. Ky Memorandum është nënshkruar dhe vulosur në dy kopje origjinale, nga një për secilën palë.
2. Memorandumi hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit nga palët.

#### **Neni VII**

##### **Nënshkrimi**

1. Memorandumi është nënshkruar nga përfaqësuesit e Drejtorisë Komunale të Arsimit të Komunës së Obiliqit dhe organizatës Teach For Kosova:



**Fitore Hashani**

**Drejtoreshë, DKA - Komuna e Obiliqit**

**Egzon Gashi**

**Drejtor, Teach For Kosova**

14 maj 2025

